

Hulumtim mbi votuesit fiktiv në Maqedoni (1)

Manipulimi me votat fiktive bëhet për llogari të partive që janë në pushtet, gjatë kohës së mbajtjes së zgjedhjeve, pasi ata drejtojnë dy ministritë kyçe të hartimit të Regjistrat Zgjedhor, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, tregon Tito Petkovski, deputet në Parlamentin e Maqedonisë. Vetëm numri i të vdekurve në lista, thotë se duhet të jetë prej 70 mijë deri në 100 mijë

Laura PAPANIKU

Të paktën 300 mijë llogaritë të jetë numri i votave me të cilat po manipulohet në Maqedoni, duke i keqpërdorur emrat e personave të vdekur dhe të atyre që kanë migruar nga Maqedonia. Shumë njerëz rrëfejnë se gjatë evidentimit në listat zgjedhore kanë parë me sytë e tyre, që në këto lista, ndodhen emrat e familjarëve apo miqve të tyre të vdekur dhe disa të tjerë flasin për ndodhjen në lista të miqve apo të afërmeve të tyre, të cilët nuk jetojnë në Maqedoni prej shumë vitesh. Halil Palloshi nga Shkupi, tregon se ka parë në listë emrin e së ëmës, së ndjerës Nexhmije Palloshi, me numrin e amzës 1810928455101, e cila e ka ndërruar jetë parë më tepër se tetë viteve. "Sa herë shkojmë të votojmë me bashkëshorten, e cila e ka gjithashtu emrin Nexhmije, e gjejmë atyre edhe emrin e nënës sime të ndjerë. Na pyesin se për cilën Nexhmije do të votojmë, pasi janë dy me të njëjtin emër në listë", rrëfen ai. Dilemën e çastit thotë se e zgjidhë numri amzë.

"Në fillim bëjmë krahasimin e datëlindjes, që ndodhet në gjashtë shifrat e para të numrit amzë dhe, pastaj e verifikojmë edhe një herë numrin amzë të bashkëshortes përmes letërnjoftimit të saj. Të njëjtën procedurë e bëjmë çdo herë, në të gjitha zgjedhjet pa përjashtuar edhe këta të fundit, që u zhvilluan në mars", pohon Palloshi. Atij nuk i bën ndonjë përshtypje të veçantë mos largimi i emrit të së ëmës nga Regjistri Zgjedhor. Raste të këtilla, ka sa të duash, thotë Palloshi, i cili në mars të 2009-ës, kur

Në Maqedoni, edhe të vdekurit votojnë



në Maqedoni u zhvilluan zgjedhjet e përbashkëta lokale dhe presidenciale, ishte nënkryetar i Komisionit Zgjedhor në Çashkë. Në këtë komunë, që ndodhet në pjesën qendrore të Maqedonisë, sikurse pohon Palloshi, përveç prezencës së njerëzve të vdekur ka pasur edhe parregullsi të tjera, si përdorimi i dy aparateve ultraviolete, njëri që funksionon në rregull dhe tjetri i prishur, që nuk reagon për të dedikuar nëse personi ka votuar më herët ose jo. "Këta perona, që zakonisht janë militantë të partisë e cila ka pushtetin dhe që paraqiten në vendvotime ku kryetarët e komisioneve zgjedhore janë gjithashtu njerëz të po asaj partie, kalojnë kontrollin të aparatit i prishur, të cilin paraprakisht janë kujdesur që t'ia besojnë personit të tyre".

Pasi kanë votuar një herë në vendvotimet ku banojnë aktualisht, ata vinë të votojnë në vendvotimet tjera të vendbanimeve të tyre të përparshme, ku dikur kanë qenë banorë dhe nuk janë larguar prej listave (pra figurojnë në dy lista dhe emri i tyre është i regjistruar në dy vendbanime) ose votojnë për personat e migruar apo që nuk jetojnë në mesin e të gjallëve. Tito Petkovski, deputet në Parlamentin e Maqedonisë që në përbërjen e parë, pas pavarësim-it të shtetit në vitin 1991, thotë se manipulimi me rastet e këtilla bëhet për llogari të partive që janë në pushtet gjatë kohës së mbajtjes së zgjedhjeve, pasi ata drejtojnë dy ministritë kyçe të hartimit të

Regjistrat Zgjedhor, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme.

"Meqë e kanë në dorë të manipulojnë për interesa të veta, qeverive nuk u konvenon që të azhurnojnë listat zgjedhore nga personat e vdekur dhe nga ata që janë shpërngul, pra që nuk jetojnë në Maqedoni me vite të tëra". Petkovski, kryetar i Partisë Liberalëve, thotë se në bazë të informacioneve që posedojnë numri i personave të vdekur në listat zgjedhore duhet të sillet prej 70 mijë deri në 100 mijë. Për personat që janë shpërngulur nga Maqedonia dhe që nuk janë larguar prej listave zgjedhore edhe pse janë bërë banorë të vendeve tjera, prej shumë vitesh, duhet të jenë rreth 150 mijë persona, thotë ai. Prej vitit 2002, tregon Petkovski nisi të flitet se nga Regjistri Zgjedhor nuk janë larguar një pjesë e mirë e personave që janë të vdekur ose mungojnë

nga Maqedonia me nga 10-15 vite. Kjo, sikurse thotë ai, është një bazë e mirë manipulimi gjatë procesit zgjedhor.

"Këtë patëm mundësi ta vërtetojmë edhe në zgjedhjet e fundit, nga persona të afërt të partisë sonë, të cilët treguan se kanë parë në listat zgjedhore familjarët apo shokë të tyre të vdekur. Një anëtar i joni, pa në listë emrin e të ëmës, e cila i kishte vdekur vite më parë, kurse një tjetër pa emrin e kuantit (vëllait të gruas), i cili ka migruar në Amerikë dhe nuk është kthyer fare në Maqedoni më tepër se 10 vjet, kurse figuron në listat zgjedhore. Partive që janë në pushtet, nuk u konvenon të azhurnojnë listat zgjedhore, pasi kanë në rezervë një numër të mirë votash, që në start dhe me këto vota mundet të manipulon vetëm pushteti, pasi ato kanë në dispozicion edhe dokumentacionin", tregon deputeti Petkovski. Anëtarë

të komisioneve zgjedhore, në vendvotime të ndryshme rrëfejnë se si në lista kanë qene të dukshme anomali të llojit të personave të vdekur dhe të migruar me vite. Jusuf Shajani, i cili ishte nënkryetar në vendvotimin me numër 32333, në fshatin Kriva Krusha thotë se në listë ishin të shënuar tetë votues, kurse fshati kishte vetëm dy banorë. "Meqë na bëri përshtypje, u interesuam dhe pyetëm një polic të një fshati aty pranë dhe, përgjigja që morëm ishte se ca kanë vdekur dhe ca kanë shkuar të jetojnë në Slloveni", tregon Shajani. Ndërkaq, Rufki Loku, ish-komisionar në fshatin Mellnicë, me numër të vendvotimit 3228, tregon gjithashtu për prezencën në lista të personave me ditëlindje të motmotshme dhe për emra peronash, të nënvizuar me nga "*". Rast, që ka lënë për të dyshuar është ai me personat e pa aftë për të votuar. "Në raundin e parë të zgjedhjeve, kishim vetëm një person të kësaj kategorie, kurse në raundin e dytë, që u mbajt dy javë pas të parit, rezultoi se janë 13 persona të paaftë për të ardhur deri në vendet e votimit", shpjegon Loku. Në Ministrinë e Drejtësisë refuzojnë ti pranojnë si të sakta informacionet për prezencë të votuesve fiktiv. Edhe nëse ka ndonjë rast, janë raste të izoluara, të pakta, kurse të njëjtën përgjigje e kthejnë edhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Parregullsitë e listave zgjedhore dhe mosanzhurimi i tyre prej personave të vdekur dhe atyre që janë regjistruar si banorë të një shteti tjetër, kanë provokuar dukshëm dhe durimin e ndërkom-bëtarëve. Përfaqësues të institucioneve relevante, kanë nisur të zbehin retorikën diplomatike për këtë çështje dhe pas zgjedhjeve të fundit presidenciale dhe lokale që u zhvilluan në Maqedoni, në muajin mars, kanë nisur ta thonë troç: Në Maqedoni ka problem me votuesit fiktiv. Listat e votuesve duhet të azhurnohen. Vërejtje dhe shqetësime, kanë shfaqur jo vetëm institucionet ndërkom-bëtarë relevante, OSBE ODHIRI, por edhe

CIA, kurse institucionet vendore si Qeveria dhe Komisioni Shtetëror Zgjedhor, tani i janë nënshtruar insistimit të tyre për azhurnimin, pasi Maqedonia aspiron të anëtarësohet në strukturat euroatlantike. Vetëm në bazë të të krahasimit të të dhënave që jepen zyrtarisht dhe, asaj që zyrtarisht kumtohet si trup jo votues, ekziston një dallim prej 120 mijë persona po të krahasohet shifrat e para me të dytat. E nëse këtë numri i shtohen edhe 100 mijë persona, sa thuhet të jetë numri i atyre që kanë lindur në Maqedoni e që ligjërisht nuk kanë të drejtë vote (pasi më shumë se sa një vit janë banorë të një shteti tjetër) dhe i mos largimit për disa vite i personave të vdekur (mbi 70 mijë), kontingjenti i votuesve fiktiv prekën shifrën e 300 mijë-shit. Në listat zgjedhore të 2009-ës ishin të regjistruar 1 milion e 782 mijë e 82 votues, ndërsa popullsia e përgjithshme e popullatës, sipas raportit më të fundit të CIA-s për Maqedoninë nuk duhet të ketë shkuar më tepër se 2 milionë e 50 mijë banorë. Me regjistrimin e fundit të popullsisë në Maqedoni, i realizuar në vitin 2002 në rrethana jo edhe aq të qarta politike Enti Shtetëror Statistikor nxori 2 milionë e 30 mijë banorë. Pra në bazë të këtyre të dhënave, në Maqedoni nuk voton vetëm 12.6 për qind e popullatës. Demografët vërejnë se për shkak të moshës mesatare relativisht të re, në këtë vend, është absurde të besohet se ka aq përqindje të popullatës nën 18 vjet, pra që nuk ka të drejtë vote. Në Komisionin Shtetëror Zgjedhor, thonë se i kanë vërejtur anomali në Regjistrin Zgjedhor, por nuk kanë mundësi të intevenojnë, kurse institucionet e angazhuara në hartimin e atij regjistrat: Ministria e Drejtësisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Entit Shtetëror të Statistikave, ia hedhin fajin njëra-tjetres. (vijon)

(Kjo storje është mbështetur nga SCOOP dhe Shoqata Daneze për Gazetari Hulmuese)



HALIL PALLOSHI

Sa herë shkojmë të votojmë me bashkëshorten, e cila e ka gjithashtu emrin Nexhmije, e gjejmë atyre edhe emrin e nënës sime të ndjerë. Na pyesin se për cilën Nexhmije do të votojmë, pasi janë dy me të njëjtin emër në listë



TITO PETKOVSKI

Meqë e kanë në dorë të manipulojnë për interesa të veta, qeverive nuk u konvenon që të azhurnojnë listat zgjedhore nga personat e vdekur dhe nga ata që janë shpërngul, pra që nuk jetojnë në Maqedoni me vite të tëra

Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Drejtor: Arben Ratkoceri

Kryeredaktor: Besim Iljazi • Zëvendëskryeredaktor: Vedat Memedaliu • Ndihmëskryeredaktor: Shkëlzen Halimi

Redaktorë: Evis Halili, Ilir Ivanovski, Avdyl Salihu • Redaktor teknik: Halil Berisha

E-mail: koha@koha.com.mk • Tel: 02 3179 - 904; Fax: 02 3118 - 060; Adresa: Bul. Goce Dellçev Nr.11/2 (Q.T. Mavrovka) - Shkup

MARKETING: marketing@koha.com.mk - Tel: 02 3179-904; 02 3299-871

NPK "Koha Produkcija" Num. i xhirrollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Num. i Tat. 4030008022772

Koha

E përditshme informative
www.koha.com.mk

Shtyp: "Misirkov" - Shkup

Hulumtim mbi votuesit fiktiv në Maqedoni (2)

"Është shumë me rëndësi që listat të azhurnohet para kohës së mbajtjes së zgjedhjeve të ardhshëm, pavarësisht se kur do zhvillohen ato", pohon ambasadori Herrero

Laura PAPANIKU

Në bazë të numrit të votuesve, që zyrtarisht u kumtuan nga Ministria e Drejtësisë (1. 782 082 votues), në Maqedoni i bie të ketë 357 mijë e 918 mijë popullsi jo votuese (prej moshës zero në 18 vjet). Kjo shifër bie ndesh me të dhënat statistikore mbi numrin e nxënësve të shkollave dhe atyre që zyrtarisht janë deklaruar jashtë procesit arsimor e që bashkërisht rezultojnë të përbëjnë 328 mijë e 877 persona të moshës prej gjashtë deri në 18 vjet. Nëse llogarisim këtu edhe 156 mijë fëmijët e moshës jo shkollorë, prej zero deri në 6 vjet dhe nëse heqim 8 mijë e 300 maturantë (sa thuhet se mund të jetë maksimalisht numri i atyre nxënësve që kanë mbi 18 vjet kur e mbarojnë shkollimin e mesëm), pra vetëm nga kjo përllogaritje i bie që në Maqedoni të ketë 477 mijë e 577 persona dhe jo 357 mijë e 918 sa nxjerrin shifrat e numrit të përgjithshëm të popullatës dhe numri i pjesëmarrësve në regjistrin zgjedhor. Në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, ku u drejtuam për të marrë numrin e nxënësve të shkollave, prej klasës së parë deri në vitin e katër të shkollës së mesme, tregojnë se në vitin shkollor 2008/2009 janë të kyçur 311 mijë e 377 mijë nxënës, prej të cilëve 303 073 janë të moshës prej gjashtë deri në 18 vjet. Sasho Ordevski, nga kabineti i ministrit të Arsimit dhe Shkencës, deklaroi se në shkollimin fillor, që përfshijnë fëmijët e moshës prej gjashtë deri në 14 vjet, gjenden 217 mijë e 459 nxënës. Ndërkaq, në arsimin e mesëm, thotë se janë 93 mijë e 918 nxënës. Në vitin e katër të shkollës së mesme, ku numëroheshin 20 mijë e 759 maturantë vetëm 8 mijë e 304 nxënës mund të kishin mbushur moshën e votimit. Ndërkaq, jashtë shkollës, gjenden mbi 18 mijë fëmijë të moshës shkollorë, kurse mbi 156 mijë të tjerë janë fëmijë të moshës prej zero deri në gjashtë vjet. Dragi Zmijanac, drejtor ekzekutiv i Ambasadës së parë të fëmijëve "Megjashi", në Shkup, thotë se numri i

Të gjitha matematikat konfirmojnë manipulimin



JOSE JUIS HERRERO
Është shumë me rëndësi që listat të azhurnohet para kohës së mbajtjes së zgjedhjeve të ardhshëm, pavarësisht se kur do zhvillohen ato. Pasi mbarojnë zgjedhjet të gjithë flasin, premtojnë se do ti azhurnojnë listat. Mirëpo, kur vjen koha e duhur, në prag të zgjedhjeve, harrohet disi kjo punë. Prandaj, që t'i jepet fund fenomenit "votues fiktiv"

fëmijëve të moshës shkollorë që gjenden jashtë shkollës është gati i barabartë me atë të personave të rritur që nuk kanë kryer shkollim. "Në Maqedoni janë rreth 18 e 500 fëmijë, të moshës shkollorë që gjenden jashtë procesit arsimor si dhe 20 mijë të rritur që nuk kanë kryer shkollim", deklaroi ai, ndërsa thotë se thotë se shifrat mbi numrin e fëmijëve jashtë shkollave janë zyrtare, pasi janë

deklaruar nga kompetentët. "Vetë ministrat e përparshëm të Arsimit dhe të Punës dhe Politikës Sociale kanë raportuar se 5 për qind e fëmijëve nuk shkojnë në shkollë, donë të thotë se janë mbi 18 mijë fëmijë", thotë Zmijanac. Këtë fëmijë, janë pjesë e popullsisë jo votuese bashkë me 156 mijë të tjerët e moshës prej zero deri në gjashtë vjet dhe bashkë me 303 mijë e 073 fëmijët e shkollave, të moshës prej gjashtë deri në 18 vjet. Të gjithë bashkë bëjnë një popullsi jo votuese prej 477 mijë e 073 personave. Ky numër është për rreth 120 mijë veta më shumë se popullata jo votuese prej 357 mijë e 918, që del si rezultat i minusimit të numrit të votuesve nga numri i popullsisë të përgjithshme të Maqedonisë (2 milion e 50 mijë). Ekspertët vlerësojnë se është e pamundur që në Maqedoni të ketë 357. 918 mijë jo votues. Anëtarë të komisioneve zgjedhore, në vendvotime të ndryshme rrëfejnë se si në lista kanë qene të dukshme anomali të llojit të personave të vdekur dhe të migruar me vite. Jusuf Shajani, i cili ishte nënkryetar në vendvotimin me numër 32333, në fshatin Kriva Krusha, thotë se në listë ishin të shënuar tetë votues, kurse fshati kishte vetëm dy banorë. "Meqë na bëri përshtypje, u interesuam dhe pyetëm një polic të një fshati aty pranë dhe përgjigja që morëm ishte se ka kanë vdekur dhe ca kanë shkuar të jetojnë në Slloveni", tregon Shajani.

Ndërkaq, Rufki Loku, ish-komisionar në fshatit Mellnicë, me numër të vendvotimit 3228, tregon gjithashtu për prezencën në lista të personave me ditëlindje të hershme dhe për emra peronash, të nënvizuar me nga "**". Rast, që ka lënë për të dyshuar është ai me personat e pa aftë për të votuar. "Në raundin e parë të zgjedhjeve, kishim vetëm një person të kësaj kategorie, kurse në raundin e dytë, që u mbajt dy javë pas të parit, rezultoi se janë 13 persona të paaftë për të ardhur deri të në vendet e votimit", shpjegon Loku. Numri i votuesve në Regjistrin zgjedhor dhe me këtë edhe i anomalive, nga viti në vit, ritet, gjë që tregon se me gjithë premtimet e qeverive për të azhurnuar listat, një gjë e tillë nuk ka ndodhi. Në këtë temë flet edhe njeriu i parë i OSBE-së për Maqedoninë. Ambasadori Jose Juis Herrero, thotë se në Maqedoni është evidente kjo dukuri, e cila vjen si rezultat i mos azhurnimit të listave zgjedhore. "Është shumë me rëndësi që listat të azhurnohet para kohës së mbajtjes së zgjedhjeve të ardhshëm, pavarësisht se kur do zhvillohen ato" pohon Herrero. Pasi mbarojnë zgjedhjet, vëren më tej ai, të gjithë flasin, premtojnë se do ti azhurnojnë listat. "Mirëpo, kur vjen koha e duhur, në prag të zgjedhjeve, harrohet disi kjo punë. Prandaj, që t'i jepet fund fenomenit 'votues fiktiv'", thotë ambasadori Herrero, duke shtuar se duhet nisur puna, që

tani dhe jo të presim që edhe zgjedhjet e ardhshme të na presin me këtë problem. Dallimi më i thellë i numrit të votuesve u regjistrua para dy viteve, kur në Regjistrin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, që u mbajtën në qershor të 2008-ës, kishte 37 mijë e 667 votues më tepër se sa në zgjedhjet parlamentare që u mbajtën në shtator të 2006 e kur në lista kishte 1 779 116 votues, për dallim prej 1 741 449 votuesve të dy viteve më parë. Në zgjedhjet e fundit, që u mbajtën në mars të 2009-ës kishte vetëm 2 966 votues më shumë se në vitin 2008. Pra për dallim prej kësaj rritje normale (gati tri mijë votues për një vit) kemi rritjen jo normale (mbi 37 mijë për dy vjet). Ixhet Memeti, ish-ministër i Drejtësisë, thotë se faji nuk duhet kërkuar tek Regjistrin Zgjedhor, por mbase të regjistrimi i popullatës. "Në pamje të parë, duket se ka parregullsi pasi dallimi mes popullsisë votuese dhe popullatës së regjistruar është shumë i ngushtë. Në Maqedoni bëhet regjistrimi i popullatës rezidente, pra që ndodhet momentin e regjistrimit. Nuk duhet të harrojmë se ditën e regjistrimit, në Maqedoni nuk janë ndodhur numër i madh i shtetasve të cilët edhe jetojnë në botën e jashtme, nuk e kanë humbur të drejtën e votës, pasi janë banorë të këtij vendi", thotë Memeti.

Njeriu, mund të ketë dy shtetësi, mirëpo vetëm një vendbanim. Edhe në

**IXHET MEMETI**

Në pamje të parë, duket se ka parregullsi pasi dallimi mes popullsisë votuese dhe popullatës së regjistruar është shumë i ngushtë. Në Maqedoni bëhet regjistrimi i popullatës rezidente, pra që ndodhet momentin e regjistrimit. Nuk duhet të harrojmë se ditën e regjistrimit, në Maqedoni nuk janë ndodhur numër i madh i shtetasve të cilët edhe jetojnë në botën e jashtme, nuk e kanë humbur të drejtën e votës, pasi janë banorë të këtij vendi

rastin e shpërnguljes, sipas ish-ministrit, ai nuk mund të shënohet si banor i vendit të ri nëse nuk është shlyer nga lista e vendbanimit të vjetër. Mirëpo, praktika e tregon të kundërtën. Në Maqedoni vazhdojnë të llogariten si banorë të vendeve të caktuara jo vetëm personat që janë regjistruar si banorë të shteteve të huaja, por edhe ato që kanë lëvizur nga njëri vend në tjetrin, brenda shtetit. I këtuillë është edhe rasti i B. Ilazit, nga Gostivari, i cili në zgjedhjet e fundit figuronte i regjistruar edhe në vendbanimin me numër 0526 edhe në atë me numër 0411. Ai, ka vite që nuk jeton më në fshat dhe është banor i qytetit, mirëpo emri i tij qëndron në listat e të dyja vendbanimeve. Në Ministrinë e Drejtësisë, ku kërkua të na mundësojë qasje në listat e këtyre dy vendbanimeve, për të verifikuar vërtetësinë e informacionit të lartshënuar nuk u treguan të gatshëm për bashkëpunim edhe përkundër shpjegimit se kërkesa është në interes të hulumtimit, për parregullsitë edhe anomalitë që e shoqërojnë Regjistrin Zgjedhor.

(vijon)

(Kjo storje është mbështetur nga SCOOP dhe Shoqata Daneze për Gazetari Hulumtuese)


Hulumtim mbi votuesit fiktiv në Maqedoni (3)

Mashtrimi i madh

Në zgjedhjet e fundit, që u mbajtën në Maqedoni në muaji mars, ishte vështirësuar mundësia e përdorimit në masë të votuesve fiktiv. Kjo, shpjegohet me rënien e përqindjes së daljes në votime

Laura PAPANIKU

Në Maqedonia asnjëherë nuk janë pastruar listat prej personave të vdekur, prandaj edhe kemi një kontingjent votuesish fiktiv, i cili mund të shkojë deri në 300 mijë. Kështu e shpjegon demografi Asllan Selmani dilemën nëse në Maqedoni ka gjasa reale që 87 për qind e popullatës të jetë mbi moshën 18 vjeçare, gjykuar sipas numrit të votuesve në përpjesëtim me numrin e banorëve. "Në lista mund të figurojnë 1 milion e 780 mijë votues, por në praktikë mendoj se Maqedonia duhet të ketë rreth 1 milion e 500 mijë



me të cilën lëvizën zhvillimi i popullatës në Maqedoni, fizikisht duhet të ketë një rritje të popullsisë votuese. Mirëpo, jo të asaj mase, deri ku ka mbërritur në listat e përpiluara enkas për zgjedhjet, sidomos atyre të vitit 2008 kur kishim një rritje enorme të votuesve: mbi 37 mijë e 600 votues më shumë se ato të 2006-ës. Problemi i votuesve fiktiv, sipas tij, qëndron në atë se asnjëherë nuk është bërë pastrimi i listave prej personave të vdekur si dhe personave që gjenden jashtë shtetit dhe që kanë humbur të drejtën e votës. "Pra, listave të pa pastruara të zgjedhjeve të kaluara, u janë shtuar edhe persona të tjerë votues fiktiv", shpjegon ai.

Kontingjenti prej rreth 340 mijë votuesve ka lënë gjurmë të dallueshme dhe të lexueshme lehtë nëpër krahasime shifrash dhe statistikash zyrtare. Kështu, në bazë të dhënave për numrin e banorëve dhe të votuesve nëpër komuna të caktuara dalin në shumë votues se banorë, që flet qarët për mos azhurnimin e listave nga personat e vdekur, atyre që vitet të tëra nuk jetojnë në Maqedoni dhe atyre që u është dhënë një adresë vetëm sa për tu dhënë një nënshkruar maqedonase. "Ka dyshime për manipulime të këtylla, mirëpo Komisioni Shtetëror Zgjedhor, as nuk ka pasur mundësi dhe as kompetencë të ndikojë", deklaroi Saubi Jakupi, nënkryetar i këtij Komisioni. Regjistri Zgjedhor, që përgatitet nga Ministria e Drejtësisë, Enti Shtetëror Statistikor dhe Ministria e Punëve të Brendshme, Jakupi, thotë se në KSHZ shkon vetëm një muaj para se të mbahen zgjedhjet, kështu që Komisioni gjendet para aktit të kryer. "E aprovuam Regjistrin Zgjedhor ashtu sikurse na vjen, sepse nuk ka kohë për të intervenuar, pra për ta korrigjuar atë që është përgatitur nga institucionet e lartpërmendura, kurse KSHZ nuk ka as qasje në metodologjinë e hartimit të listave. Nuk kemi as kohë dhe as mundësi për të intervenuar, sepse KSHZ nuk ka qasje në atë se si është përgatitur", thotë Jakupi.

Për të vërtetuar prezencën e votuesve fiktiv, sipas procedurave duhet të shkohet me raste

konkrete, për persona konkret. Pra vetëm atëherë mund të kërkohet sqarime. Duke pasur parasysh rrethanat: kohën e shkurtër në dispozicion, hedhja e përgjegjësisë nga njëri institucion në tjetrin, në KSHZ askush nuk ndërmer iniciativë të këtylla.

"Është shumë vështirë, gati

raste të këtylla, shpjegojnë se "manipulimi i takon Ministrisë së Punëve të Brendshme, pasi në kompetencat e saja bie edhe regjistri me adresat e vendbanimeve". Pra, kjo kategori e personave është regjistruar nëpër adresa fiktive dhe nuk ka mundësi të zbulohen, sepse edhe dhënia e shtetësisë edhe regjistri i adresave janë në dorën e kësaj ministrie. Ndërkaq, përgjegjësia për parregullsitë në regjistrin Zgjedhor shpërndahet në më tepër institucione. Në zgjedhjet e fundit, që u mbajtën në Maqedoni në muaji mars, ishte vështirësuar mundësia e përdorimit në masë të votuesve fiktiv. Kjo, shpjegohet me rënien e përqindjes së daljes në votime. Analistët thonë se nuk është zvogëluar jehona reale e njerëzve në votim, është ngushtuar rrethi i manipulimeve me votat fiktive dhe kjo për shkak të insistimit të huajve që listat të azhurnohen dhe Regjistri Zgjedhor të pastrohet nga votuesit fiktivë. Që të jepe fund manipulimit përmes votave fiktive, Qeveria e Maqedonisë është detyruar që në bashkëpunim me Sekretariati për çështje të integritetit euroatlantike, Ministrinë e Drejtësisë, Entin Shtetëror të Statistikave, Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe Komisionin Shtetëror Zgjedhor, është detyruar të ulet dhe të përgatitën Planin dhe Metodologjinë për Revizion të Regjistrin Zgjedhor (PRRZ dhe MRRZ). Ky plan duhet të dërgohet Qeverisë në formë propozimi, kurse pas kësaj duhet të formohet një Trupi koordinues, i cili do të japë vlerësimet, vërejtjet dhe në fund do të miratojë PRRZ-në dhe MRRZ-në. Në atë trup koordinues, do të marrin pjesë edhe përfaqësues të partive politike parlamentare. Kjo pritet ti jep fund edhe manipulimit, që deri tani ka shkuar në favor të partive që ishin në pushte momentin e mbajtjes së zgjedhjeve. 300 mijë vota fiktive, në garën për deputetë do të thonë 25 karrige të fituara gratis. (fund)

(Kjo storje është mbështetur nga SCOOP dhe Shoqata Daneze për Gazetari Hulumtuese)

Kronikë

Vritet dhe hidhet në deponi

Me disa plumba në kokë dhe në trup, të enjten pasdite në rrugën rajonale Shkup-Kumanovë është gjetur i vrarë 42-vjeçari, Agim Sherifi nga Haraçina e Shkupit. Sipas të dhënave policore, trupi i pajetë i burrit rreth orës 15 është gjetur nga kumanovari 50-vjeçar me iniciale A.J. i cili ka alarmuar policinë. Nga dalja e ekipeve policore në vendin ku ishte gjetur trupi i pajetë, në deponinë në afërsi të fshatit Orllancë, është vërtetuar identiteti i 42-vjeçarit, i cili sipas policisë, ka qenë i njohur për organet e rendit si kryerës i një numri të madh të veprave penale. Kontrolli i ekspertëve mjekoligjior ka vërtetuar se banori i Haraçinës është ekzekutuar me disa plumba. Sipas hetimeve paraprake, Agim Sherifi është rrëmbyer disa ditë më parë dhe më pas është vrarë. Gjatë viteve 2004-2008, për një vrasje të mbetur në tentativë, ai ka vuajtur burg në burgun e Idrizovës.

Vetura i merr jetën 67-vjeçares

Një grua 68-vjeçare nga fshati Tuin i Kërçovës ka humbur jetën si pasojë e goditjes së veturës së tipit "Audi", të drejtuar nga 47-vjeçari, I.H. nga fshati Velehtë i Strugës, informon policia. Sipas të dhënave të saj, në aksidentin e ndodhur rreth orës 13 të mesditës së enjte, në rrugën magjistrale Gostivar Kërçovë, ka humbur jetën gruaja me iniciale Z.M. E moshuara ka gjetur vdekjen duke ecur në rrugë, pas goditjes së "Audisë". Për shkak të lëndimeve të rënda të marra nga goditja e automjetit, ajo është dërguar në spital, por atje ka ndërruar jetë. Policia ka hetuar vendin e aksidentit dhe ka marrë masa për zbardhjen e tij.

Paraburgosen dy të rinj

Një ditë pas grabitjes së 27-vjeçarit me iniciale B.F. nga fshati Çajle i Gostivarit, policia ka vënë në pranga bashkëfshatarët e tij D.R. (18) dhe J.I. (17), të cilët dyshohet se janë autorë të grabitjes. Njoftimi policor bën me dije se hetimet policore kanë çuar në arrestimin e dy të rinjve, kundër të cilëve rëndon akuzat për grabitjen e 27-vjeçarit. Par arrestimit, kundër tyre janë ngritur padi penale, ndërsa dërgimi në gjykatë ka rezultuar me shqiptimin e masës paraburgim. D.R. ka përfunduar në paraburgim 30 ditë, ndërsa J.I. do të qëndroj në paraburgim 15 ditë. Dy të rinjtë një ditë para arrestimit, me maska në kokë, e rrahën B.F. dhe prej tij arritën të marrin 700 euro.

(I.I.)

ASLLAN SELMANI



Në lista mund të figurojnë 1 milion e 780 mijë votues, por në praktikë mendoj se Maqedonia duhet të ketë rreth 1 milion e 500 mijë votues. Në asnjë mënyrë nuk ka gjasa që 87 për qind e popullatës të jetë mbi moshën 18 vjeçare

votues", pohon Asllani, duke sqaruar se në asnjë mënyrë nuk ka gjasa që 87 për qind e popullatës të jetë mbi moshën 18 vjeçare. Nga 2 milionë e 50 mijë sa mund të ketë shkuar numri i përgjithshëm i popullatës në Maqedoni, në listat e zgjedhjeve të fundit janë evidentuar 1 milion e 782 082 votues, apo 87 për qind e popullsisë së përgjithshme. Sipas kësaj, pragu e votimit nuk e ka kaluar vetëm 13 për qind e banorëve të Maqedonisë. "Në asnjë rast, nuk mundet të jetë 13 për qind numri i popullatës, prej zero deri në 18 vjeç", thotë Selmani, profesor në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, të Shkupit. "Moshë e popullatës nën 18 vjet, sipas të gjitha parametrave, sillet prej 27 deri më 30 për qind, pasi moshë rinore (deri në 19 vjet) është 33 për qind". Demografi Selmani, shpjegon se mbi bazën e dinamikës

SUHBI JAKUPI



E aprovuam Regjistrin Zgjedhor ashtu sikurse na vjen, sepse nuk ka kohë për të intervenuar, pra për ta korrigjuar atë që është përgatitur nga institucionet e lartpërmendura, kurse KSHZ nuk ka as qasje në metodologjinë e hartimit të listave. Nuk kemi as kohë dhe as mundësi për të intervenuar, sepse KSHZ nuk ka qasje në atë se si është përgatitur

se e pamundur të vërtetohet se një njeri është regjistruar dy herë, në dy vendvotime, apo të kesh njohuri për 1 milion e 800 mijë persona se kush është gjallë e kush jo dhe kush jeton në Maqedoni apo në migracion, më tepër se një vit", shpjegojnë në KSHZ. Kjo ka bërë të mundur që listat të mos pastrohen asnjëherë prej votuesve fiktiv. Ose, kur janë pastruar pjesërisht, për shembull nga "diaspora" nuk janë hequr të vdekurit dhe janë shtuar të rinj si "maqedonasit e Lubes". Në Komisionin Shtetëror Zgjedhor (KSHZ) ku jo zyrtarisht flitet për 10 mijë